

RREGULLORE E NJËSISË SË BRENDSHME TË SIGURIMIT TË CILËSISË

KREU I NORMA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Misioni

Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë, është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në Universitetin POLIS.

Neni 2 Baza ligjore

Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë (NJBSC), funksionon në përputhje me përcaktimet e ligjit për arsimin e lartë në fuqi, akteve nënligjore në zbatim të tij, udhëzimeve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Statutit të Universitetit POLIS.

Neni 3 Bashkëpunimi me ministrinë

NJBSC-ja e Universitetit POLIS, bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë si dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në përputhje me dispozitat e ligjit mbi arsimin e lartë dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

KREU II VLERËSIMI I CILËSISË

Neni 4 Planet institucionale për zhvillim të cilësisë

1. NJBSC përgatit projekt-plane të zhvillimit institucional për vlerësimin, të cilët miratohen nga Senati Akademik dhe mund t'i paraqiten për informim APAAL.
2. Njësia ndjek zbatimin e planeve për zhvillimin e sigurimit të cilësisë, të përputhura nga ajo vetë.



3. Njësia vlerëson ecurinë e zhvillimit të cilësisë në përgjithësi përfshi atë të procesit mësimor sipas elementëve të paraqitur në programet e lëndëve përkatëse dhe elementëve të tjerë që lidhen me të.
4. Njësia raporton direkt në organet me të larta të Universitetit, në lidhje me rezultatet e vlerësimit të cilësisë, duke bërë sipas rastit edhe rekomandime në lidhje me aspekte të ndryshme, në funksion të rritjes së cilësisë.

Neni 5

Parimet themelore dhe veprimtaria e Njësisë

1. Parimet themelore ku mbështetet Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë dhe kuadri operativ i NjBSC janë:
 - a. Universiteti POLIS mban përgjegjësinë kryesore për cilësinë e ofertës akademike dhe formimit të studentëve e diplomave që lëshojnë;
 - b. Universiteti duhet të mbrojë dhe ruajë interesat e studentëve dhe shoqërisë në tërësi për cilësi, standarde dhe punësimin që rrjedh nga formimi akademik;
 - c. Cilësia e programeve akademike nevojitet të zhvillohet dhe të përmirësohet vazhdimisht si për studentët ashtu dhe për përfituesit e tjerë të institucionit dhe tregun e punës;
 - d. Universiteti duhet të ketë struktura organizative të dobishme dhe efikase brenda të cilave mund të sigurohen, mbështeten dhe zhvillohen programet akademike;
 - e. Transparenca dhe përdorimi i ekspertizës së jashtme në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të rëndësishme;
 - f. Duhet të inkurajohet krijimi i një kulture cilësie brenda institucioneve të arsimit të lartë;
 - g. Duhet të zhvillohen procese, përmes të cilave Universiteti POLIS mund të tregojë përgjegjshmërinë e tij, duke përfshirë përgjegjshmërinë për investimin e të ardhurave publike dhe private;
 - h. Universiteti duhet të jenë në gjendje të tregojnë cilësinë e tij brenda vendit dhe ndërkombëtarisht, por dhe ndaj komunitetit akademik dhe shoqëror.
 - i. Proceset dhe sistemet e zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë të përdorura nga Universiteti nuk duhet të kufizojnë e kufizojnë shumëllojshmërinë, risinë dhe lirinë e krijimtarinë akademike.
2. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë e shtrin fushën e veprimit të saj në:
 - a. analizën në përmbajtje të programeve të studimit, pas marrjes së feedbackut nga studentët, pedagogët, studentët e punësuar dhe tregu i punës;
 - b. përjasjen ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin në formë dhe përmbajtje të programeve që ofron;
 - c. vlerësimin e aktivitetit kërkimor-shkencor individual dhe institucional si dhe adresimin e përfshirjes së studentëve veçanërisht të cikleve të dyta e të treta të studimit në kërkim konkret e bashkëkohor;
 - d. vlerësimin shumëdimensional të stafit mësimdhënës e mbështetës mbi bazën e treguesve të qartë, specifike e të njohur;
 - e. vlerësimin në funksion të qëllimit, të faciliteteve, burimeve materiale, logjistikës dhe shërbimeve të tjera ndaj studentëve e komunitetit në përgjithësi, në

- funksion të programeve të studimit, strategjisë institucionale e objektivave të formimit;
- f. vlerësimin e financimit dhe burimeve njerëzore në funksion të procesve kryesore të mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe asistimit të studentëve sipas kërkesave e nevojave bashkëkohore të jetës akademike e punësimit;
 - g. fokusimin në vlerësimin e dimensionit kombëtar dhe ndërkombëtar të institucionit, bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, ofertën akademike të përbashkët në nivel rajonal e ndërkombëtar si dhe marrëdhëniet me publikun në përgjithësi;
 - h. vlerësimin e hapjes dhe marrëdhënieve të institucionit me tregun e punës, lokal, kombëtar, rajonal e më gjerë për identifikimin, rritjen e mundësive dhe të cilësisë së punësimit të studentëve të të gjitha niveleve e programeve të studimit;
 - i. vlerësimin e efektshmërisë dhe përputhshmërisë së zhvillimeve në planin institucional, akademik e kërkimor me qëllimet, synimet e objektivat zhvillimore të Universitetit;
 - j. vlerësimi i aspekteve akademike, kërkimore, administrative, menaxheriale mbi bazën e treguesve të përgjithshëm dhe specifikë (Tregues të përgjithshëm dhe të veçantë të performancës).

Neni 6

Procesi i vlerësimit të procesit mësimor

1. Vlerësimi i procesit mësimor bazohet në tre përberës: vlerësimi nga studentët; vlerësimi nga kolegët; vetëvlerësimi.
2. Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë vlerësimi: nga studentët, kolegët, vetëvlerësimi (vetvetja) dhe nga eprori/ët. Këto përqindje mund të ndryshojnë, me vendim të NJBSC, vetëm duke rritur ndikimin e vlerësimit të studentit në vlerësimin e përgjithshëm.
3. Secili nga vlerësimet, realizohet në bazë të formularëve, që hartohen në përputhje me praktikat më të mira europiane në vlerësimin e cilësisë dhe miratohen me shumicë votash nga anëtarët e NJBSC.
4. Organizimi i procesit të vlerësimit realizohet nga NJBSC.
5. Në përfundim të procesit të vlerësimit, Dekanët e fakulteteve duhet të informojnë pedagogët në lidhje me rezultatet e vlerësimit.
6. Rezultatet e formularëve dokumentohen e ruhen në një dosje të veçantë nga NJBSC për të paktën tre vjet, për secilin fakultet.
7. Vlerësimi realizohet në fund të çdo lënde të zhvilluar, me përjashtim të rasteve të veçanta për arsye objektive dhe të motivuara. Të dhënat e mbledhura, nga vlerësimi i studentëve, mund të përdoren për vlerësimin e pedagogut vetëm nëse më shumë se 50% e studentëve që ndjekin lëndën, i ka plotësuar formularët.
8. Vlerësimi i procesit mësimor nga kolegët, ka për synim vlerësimin e një sërë elementësh të procesit akademik për secilën lëndë si: koncepti i programit, procesi mësimor, përditësimi i saj, baza materiale e përdorur, puna kërkimore e lidhur me

lëndën, literatura, efikasiteti etj. Vlerësimi realizohet gjatë semestrit për çdo lëndë të zhvilluar.

9. Vetëvlerësimi realizohet për çdo lëndë të zhvilluar.

KREU III PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI

Neni 7 Përbërja

1. Njësia përbëhet nga 9 anëtarë, 5 staf akademik pa kompetenca ekzekutive që i përkasin të tre fakuleteve përkatëse, një përfaqësues nga sekretaria mësimore, një përfaqësues i studentëve, një përfaqësues nga komuniteti i biznesit, dhe një përfaqësues Alumni.
2. Drejtues i kësaj njësie do të jetë njëri nga pedagogët e brendshëm pa kompetenca ekzekutive.
3. Rektorati ka përgjegjësinë të sigurojë përkrahje teknike për NJBSC.

Neni 8 Mbledhjet periodike

Njësia mbledhet periodikisht dy herë në vit, për të diskutuar mbi: punën e kryer, çështje të organizimit të cilësisë, procesin e hartimit të planit institucional për sigurimin e cilësisë, procesin e monitorimit të sigurimit të cilësisë, vendosjen e indikatorëve, konkluzionet e monitorimit, rekomandimet etj.

Neni 9 Rendi i ditës

1. Rendi i ditës, vendi, data dhe ora vendosen nga kryetari i njësisë.
2. Rendi i ditës i njoftohet anëtarëve të tjerë, të paktën 3 ditë pune përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të realizohet me mjete elektronike ose me postë.

Neni 10 Kuorumi

1. Mbledhja quhet e hapur nëse janë të pranishëm të paktën tre anëtarë të njësisë.
2. Në rast se janë të pranishëm më pak se tre anëtarë, data e mbledhjes së ardhshme përcaktohet nga kryetari dhe i njoftohet anëtarëve sipas përcaktimeve të nenit 8 pika 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 11 Drejtuesi i mbledhjes

1. Mbledhjet periodike drejtohen nga kryetari i njësisë, i cili në mungesë duhet t'ja delegojë këtë detyrë një anëtar tjetër.
2. Drejtuesi i mbledhjes duhet të zgjedhë njërin prej anëtarëve për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes. Anëtar i zgjedhur, duhet të dorëzojë procesverbalin

brenda 7 ditësh pune nga mbyllja e mbledhjes, pranë kryetarit të njësisë i cili duhet ta firmosë. Procesverbali i firmosur arkivohet në dokumentacionin e njësisë.

3. Secili prej anëtarëve, pasi të ketë komunikuar me kryetarin ka të drejtë të tërheqë kopje të procesverbaleve të mbledhjes.

Neni 12 Pjesëmarrës në mbledhje

1. Në mbledhjet e njësisë, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve drejtuese të Universitetit POLIS, të cilëve mund t'u kërkohet nga drejtuesi i mbledhjes, të japin mendime në lidhje me çështje të rendit të ditës.

Neni 13 Mbledhjet me kërkesë të anëtarit ose anëtarëve

1. Secili nga anëtarët e njësisë ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e njësisë sa herë që e gjykon të arsyeshme.
2. Anëtari ose anëtarët që kanë kërkuar mbledhjen duhet të përcaktojnë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
3. Njoftimi i anëtarëve të tjerë realizohet sipas përcaktimeve të nenit 9 pika 2 të kësaj rregulloreje.
4. Mbledhja, në këtë rast, drejtohet prej anëtarit që e ka kërkuar, ose në rast se është kërkuar nga më shumë se një anëtar, drejtohet nga njëri prej anëtarëve i zgjedhur nga kryetari ose i deleguari prej tij.
5. Në lidhje me procesverbalin e mbledhjes zbatohen përcaktimet e nenit 11 pika 2 dhe 3.
6. Në lidhje me pjesëmarrësit në mbledhje zbatohen përcaktimet e nenit 12.
7. Në lidhje me kuorumin zbatohen përcaktimet e nenit 10.

KREU IV AKTET E NJËSISË SË BRENDSHME TË SIGURIMIT TË CILËSISË

Neni 14 Vendimet

1. Njësia, me shumicë të thjeshtë votash, nxjerr vendim në lidhje me instrumentet që do të përdoren për vlerësimin e cilësisë.
2. Vendimet duhet të firmosen nga kryetari i njësisë dhe arkivohen në dokumentacionin e njësisë. Një kopje e tyre duhet t'u dorëzohet organeve drejtuese të Universitetit POLIS.

Neni 15 Rekomandimet

1. Secili nga anëtarët e njësisë, ka të drejtë të nxjerrë rekomandime të përgjithshme ose specifike në kuadër të ndërgjegjësimit për çështjet e cilësisë.
2. Rekomandimet mund t'u drejtohen: anëtarëve të stafit akademik, organeve të Universitetit POLIS ose studentëve.

KREU V RAPORTET

Neni 16 Raportet semestrale

1. Raportet semestrale hartohen në përfundim të procesit të përpunimit të të dhënave, të mbledhura në lidhje me procesin mësimor dhe jo vetëm dhe firmosen nga kryetari i NJBSC.
2. Raportet semestrale diskutohen në mbledhjen periodike të njësisë. Ato mund të diskutohen edhe në organet më të larta drejtuese të Universitetit POLIS ose me drejtues, me kërkesën e tyre.

Neni 17 Raportet vjetore

1. Raporti vjetor është një detyrim i njësisë, në përpunime me përcaktimet e legjislacionit për arsimin e lartë në fuqi dhe udhëzimet e ASCAL.
2. Raporti vjetor diskutohet në mbledhjen periodike të njësisë dhe firmoset nga të gjithë anëtarët e NJBSC.
3. Raporti paraqitet përpara Senatit Akademik të Universitetit POLIS.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet çdo akt tjetër me fuqi të njëjtë në Universitetin POLIS, si dhe çdo dispozitë e rregulloreve apo akteve të tjera, që është në kundërshtim me të.

Neni 19 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore miratohet, ndryshohet ose shfuqizohet me aprovimin e shumicës së anëtarëve të Senatit Akademik.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë mbas aprovimit.

